

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI**NDËRMJET****MINISTRISË SË BRENDSHME****DHE****INSTITUTIT TË STATISTIKAVE****PËR****KONSULTIMIN E TË DHËNAVE TË REGJISTRIT KOMBËTAR TË
GJENDJES CIVILE**

Ky memorandum mirëkuptimi (më poshtë i quajtur "Memorandumi") nënshkruhet ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë (më poshtë e quajtur "Ministria e Brendshme") dhe Institutit të Statistikave të Shqipërisë (më poshtë i quajtur "INSTAT"), ose Palët;

Duke qenë se Ministria e Brendshme, në kuadrin e Projektit të Modernizimit të Shërbimit të Gjendjes Civile,

- ka ndërtuar dhe vënë në funksionim Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (më poshtë i quajtur "RKGjC") dhe është në fazën përmbyllëse të vënies në funksionim të Regjistrit Kombëtar të Adresave (më poshtë i quajtur "RKA");
- është e angazhuar për t'u ofruar palëve të treta, institucioneve qeveritare në veçanti, shërbimet dhe aksesin në të dhënat që mundëson sistemi online i RKGjC-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- është e angazhuar për t'u ofruar palëve të treta, institucioneve qeveritare në veçanti, akses në të dhënat mbi adresat në Shqipëri, që do të mundësohen nga RKA-ja, kur ky sistem të ketë përfunduar;

Si dhe INSTAT, bazuar në ligjin nr.8669, datë 26.10.2000, "Për regjistrimin e përgjithshëm të Popullsisë dhe të Banesave", të ndryshuar, është institucioni përgjegjës për kryerjen e regjistrimit në vitin 2011;

Gjithashtu duke patur parasysh predispozicionin e Ministrisë së Brendshme, të shprehur qysh në takimet e para në maj 2010, gatishmërinë e saj për t'u përfshirë në procesin e "regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave në vitin 2011", dhe të vejë në dispozicion të këtij procesi gjithë eksperiencën e vet, sistemet e veta informatike si dhe ekspertizën e akumuluar në sistemet e teknologjisë së informacionit;

Palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Nënshkrimin e këtij memorandumi me qëllim sigurimin dhe vënien në dispozicion të INSTAT-it, të ekspertizës, kapaciteteve teknologjike dhe informacionit të nevojshëm, nga Ministria e Brendshme, duke kontribuar në lehtësimin e punës së këtij institucioni për ndërtimin e ndërfaqes elektronike, përmes konsultimit të të dhënave të RKGJC-së dhe të RKA-së.

Ministria e Brendshme, përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile:

- Do t'i sigurojë INSTAT-it, të gjitha statistikave të mundshme të detajuara të gjeneruara nga sistemi online i RKGJC-së, mbi të dhënat e popullsisë.
- Do t'i propozojë INSTAT-it, mënyrat, periodicitetin, llojin dhe sasinë e informacionit që mund të marrë nga RKGJC-ja dhe RKA-ja, kur kjo e fundit të jetë në funksionim.
- Do t'i sigurojë INSTAT-it, të dhënat e nevojshme teknike për ndërtimin e një ndërfaqeje elektronike, me qëllim përdorimin e të dhënave të RKGJC-së në faza të ndryshme të procesit të Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave.

INSTAT:

- Do të njoftojë në formë shkresore Ministrinë e Brendshme, Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, për shfrytëzimin e informacionit të nevojshëm që do t'i vihet në dispozicion.
- Do të konsultojë online të dhënat e RKGJC për nevojat e tij në procesin e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave si dhe për prodhimin e statistikave të ndryshme.
- Do të përdorë të dhënat teknike të vëna në dispozicion nga Ministria e Brendshme, për qëllimet e këtij memorandumi, duke respektuar dispozitat e parashikuara në ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".
- Do të ruajë konfidencialitetin edhe pas përfundimit të këtij memorandumi ose pas heqjes së aksesit për arsye të tjera objektive.
- Do të njoftojë Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për çdo problem që ndesh gjatë përdorimit të të dhënave të RKGJC.

Ky memorandum do të lidhet për një kohë të pacaktuar dhe është subjekt i ndryshimeve vetëm me konsensus të të dyja palëve.

Çdo palë mund të përfundojë memorandumun duke lajmëruar me shkrim palën tjetër, 30 ditë para përfundimit.

Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet negociimit dhe me mirëkuptim. Në rast se nuk arrihet zgjidhja në këtë mënyrë, memorandumi konsiderohet i përfunduar dhe i zgjidhur për të gjitha efektet.

Ky memorandum hyn në fuqi dhe bëhet efektiv me nënshkrimin e tij nga përfaqësuesit e palëve.

Memorandumi hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë.

Për MINISTRINË E BRENDSHME

ZËVENDËSMINISTRI


FERDINAND PONI

Data e nënshkrimit

11. 11. 2010

Për INSTAT

DREJTORI

INES NURJA


REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSTITUTI I STATISTIKES
TIRANE

Data e nënshkrimit

11-11-2010